



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr.12, Datë 08.11.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|-------------|
| - Z.Besjan Pesha | Kryetar |
| - Znj. Anila Jani | Nënkryetare |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtare |
| - Znj. Ledina Mandia | Anëtare |
| - Z. Altin Goxhaj | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 08.11.2010, mori në shqyrtim praktiken tregtare në lidhje me ndërprerjen e ofrimit të shërbimit të transportit qytetas falas për udhëtarët, të cilët e përfitojnë këtë sipas ligjit në fuqi, si dhe ndërprerjen e ofrimit të biletës së pajtimit mujor të përgjithshëm nga operatorët privat.

Komisioni pas shqyrtimit të çështjes

VËREN SE:

Praktika e ndërprerjes së ofrimit të biletës së pajtimit mujor për qytetarët e Tiranës, si dhe të udhëtimit falas për personat që e përfitojnë atë me ligj të veçantë, përbën objekt të ligjit nr. 9902, 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”. Sipas nenit 2 të tij, ky ligj mbulon të gjitha llojet e marëdhënieve midis konsumatorëve dhe tregtarëve.

Kjo marëdhënie nuk mbulohet nga dispozitat e ligjeve të tjera, të veçanta. Sipas nenit 10, pikës 3, nënpika d dhe nenit 72, pikës 4 të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Bashkia e Tiranës është institucion tërësisht përgjegjës për funksionimin e transportit publik urban.

Përsa më sipër, si dhe në kuptim të përkufizimeve të ligjit nr.9902 Bashkia e Tiranës në këtë rast do të konsiderohet tregtar.

Nga ana tjetër Komisioni vëren se, në bazë të ligjit nr.7581, date 07.07.1992 “Për çmimet dhe tarifatat” nenit 2, Këshilli i Ministrave cakton çmimet dhe tarifatat për një pjesë të kufizuar shërbimesh që janë bazë për nivelin e jetesës. Vendimet e Këshillit të Ministrave në zbatim të këtij ligji përcaktojnë tarifa të transportit qytetas për biletë pajtimi mujor të përgjithshëm, për një linjë, etj. Gjithashtu, me ligjin nr.8626, date 22.06.2000 “Per statusin e invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik” të ndryshuar është parashikuar udhëtimi falas për invalidët.

Në këto kushte, ndërprerja e ofrimit të këtyre shërbimeve: udhëtimit falas dhe ofrimit të biletës mujore, në kuptim të ligjit nr.9902, nenit 13, pika 1, kjo praktikë do të konsiderohet si një praktikë tregtare e padrejtë, të cilat janë të ndaluara sipas pikës 5,

të këtij neni. Gjithashtu, mbështetur në nenin 7, të ligjit nr.9902, Komisioni konstaton se, Bashkia e Tiranës nuk ka informuar qytetarët në lidhje me shërbimin e transportit qytetas, për kushtet e ofrimit të këtij shërbimi, standardet e shërbimit, disponueshmërinë etj.

Kjo praktike nuk është në përputhje me Ligjin 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”:

- **nenin 7**, sipas te cilit: “1. Tregtarët janë të detyruar, në kufijtë e veprimtarive përkatëse, t’u japin konsumatorëve të dhëna të plota dhe të sakta për mallrat dhe shërbimet e vendosura në treg ose të parashikuara për t’u vendosur në treg.
2. Të dhënat duhet të jenë të vërteta, të sakta dhe të qarta për të gjitha karakteristikat e mallrave dhe shërbimeve, si edhe për kushtet e tregtimit të tyre. Këto të dhëna duhet të përmbajnë karakteristikat e mëposhtme:
- a) natyrën, identitetin e prodhuesit, çmimin, cilësinë, sasinë, dobinë, origjinën, afatin e përdorimit, mënyrën e prodhimit dhe të përdorimit, mënyrën e mirëmbajtjes dhe garancinë e mallrave dhe të shërbimeve;
 - b) rreziqet, që lidhen me mallrat dhe shërbimet, kur këto rreziqe nuk janë të kuptueshme pa paralajmërimin përkatës;
 - c) kushtet e përgjithshme të kontratave që i ofrohen konsumatorit.
- **nenin 13, pika 1/a dhe pikës 5** sipas te cilit, “Një praktikë tregtare është e padrejtë kur është në kundërshtim me kërkesat që një tregtar pritët, në mënyrë të arsyeshme, të zbatojë ndaj konsumatorëve, në përputhje me praktikën e tregtimit të ndershëm dhe/ose me parimin e përgjithshëm të mirëbesimit në fushën respektive të veprimtarisë tregtare.”, si dhe “Praktikat e padrejta tregtare janë të ndaluara”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenin 4, pika ç, nenin 7; nenin 13, pikat 1/a dhe 5; nenin 52, pika 4 dhe nenin 55 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6/b të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008,

VENDOSI:

1. Bashkia e Tiranës të marrë masat për mos përsëritjen e shkeljeve të tilla, në lidhje me ofrimin e shërbimit të udhëtimit falas dhe biletën e pajtimit mujor, si dhe percaktimin e skemes së kompensimit të konsumatorëve të demtuar për ditët e shërbimit të munguar.
2. Bashkia e Tiranës të ndalojë shkeljen mbi mungesën e informimit të konsumatorëve, në lidhje me kushtet e ofrimit të këtij shërbimi sipas pagesës.
3. Të marrë masat për ndreqjen e shkeljes, të referuar në pikën 2, nepermjet vendosjes së të dhenave të shërbimit të transportit qytetas në pikat e ndalesave të autobusëve, si dhe publikimit të tyre në faqen zyrtare të Bashkisë së Tiranës dhe/ose fletëpalosje.
4. Publikimin e këtij vendimi.

KRYETAR I KOMISIONIT

BESJAN PESHA

